



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**VENDIM**

**K.P.P. 473/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.07.2018, shqyrtoi ankeswn me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kulaifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Artan Llozana” p.f., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje Kancelari dhe Bojra për vitin 2018 për Bashkinë, QKR, Agjensia e Pyjeve dhe SHMZSH”, me nr. REF-59330-03-28-2018, me fond limit 5,391,933 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.  
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Elbasan  
Adresa: Rr. “Qemal Stafa”, Elbasan.

**Subjekt i interesuar:**

Operatori ekonomik “Artan Llozana” p.f  
Adresa: Rr. “Rinia”, L. A. Pasha, Elbasan.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### **Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

### II

#### **Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 29.03.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje Kancelari dhe Bojra për vitin 2018 për Bashkinë, QKR, Agjensia e Pyjeve dhe SHMZSH”, me nr. REF-59330-03-28-2018, me fond limit 5,391,933 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

II.2 Në datën 10.04.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 20.04.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Artan Llozana" p.f.	3,206,232.50 lekë pa tvsh	Kualifikuar;
2. "Infosoft Office" sh.p.k.	4,164,845.91 lekë pa tvsh	Kualifikuar;
3. "4K Trading Albania" sh.p.k.	4,330,730.00 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
4. "Ferit Myftari" p.f.	4,555,000.00 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
5. "Adastra" sh.p.k.	4,878,000.00 lekë pa tvsh	Skualifikuar

II.4.Në datën 24.04.2018 operatori ekonomik ankimues "Infosoft Office" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Artan Llozana" p.f., duke argumentuar si më poshtë vijon:

*"[...]Verejme qe OE i klasifikuar i pari ka nje oferte gati 1 milion leke me te ulet sesa ne qe jemi te dytet, me diference shume te madhe edhe nga operatoret e tjere, te cilet luhaten ne vlera te peraferta. Ne keto kushte, e konsiderojme te pamundur plotesimin e specifikimeve teknike te kerkuara ne tender. Infosoft Office eshte distributor i letres dhe i shume markave te tonerave, dhe per tenderin Bashkise Elbasan,u moren oferta speciale nga furnitoret tane. Ju qartesisht keni kerkuar tonera origjinale nga prodhuesit e pajisjeve perkatese. Eshte e pamundur qe me vleren qe ka ofertuar OE i renditur i pari, te ofertohej me tonera origjinale. Madje oferta e tij eshte edhe anomalisht e ulet dhe nuk e dime sesi mund ta argumentojme ai kete vlere. A ka sjelle ky operator fatura te mepareshme qe vertetojne aftesite e tij per te blere tonera me cmime kaq te uleta? Nese po, a jane keto fatura te kompanive qe tregtojne tonera origjinale? Ne tender jane kerkuar edhe ISO 9001 te prodhuesve te tonerave. Nuk e dime se cfare dokumentash ka paraqitur OE i renditur i pari per te plotesuar kete pike. Ka paraqitur ai ISO te te gjitha prodhuesve te tonerave origjinale, apo ka paraqitur ISO te prodhuesve te tjere? Ne keto kushte, kemi bindjen qe OE i renditur i pari, nuk ploteson specifikimin kryesor, per te ofertuar me tonera origjinale te paisjeve qe ju dispononi. Kjo e bazuar edhe ne eksperiencen tone 20 vjecare ne fushen qe eshte objekt i ketij prokurimi.[...]"*

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2584/1 Prot. datë 02.05.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Infosoft Office" sh.p.k., duke mos pranuar ankesën.

II.6.Në datën 10.05.2018 pala ankimuese "Infosoft Office" sh.p.k. ka paraqitur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, në të cilën argumenton si më poshtë vijon:

*"[...]Nga pergjigja e AK na u be e qarte se OE i ishin kerkuar sqarime per oferte anomalisht te ulet, sqarime qe ishin konsideruar bindese nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave. Gjithashtu OE kishte paraqitur ne tender nje ISO 9001:2008 per menaxhimin e cilesise nr. 00113Q213497R1M/4404 te vlefshme deri ne dhjetor 2019. AK ne kriteret e kualifikimit kishte kerkuar: 5. Operatori ekonomik duhet te paraqes: Certificate ISO 9001:2008 per menaxhimin e cilesise (te vlefshme). Certifikata e kerkuara eshte certifikate qe i perket prodhuesit te tonerave. Sqarojme qe ne tender kerkoheshin 12 lloje (marka) tonerash, qe prodhohen nga 12 prodhues te ndryshem. Cdo lloj (marke) toneri ka prodhuesin e vet respektiv. Ne tender kerkoheshin tonera: Konica Minolta; Brother; Kyocera; Xerox; Canon; Ricoh; Toshiba; Lexmark; HP; Samsung; Oki; Sharp; Epson. Secili nga keta prodhues eshte kompani me vete (nuk ka asnje lidhje mes ketyre prodhuesve) dhe ka secili certifikaten e vet te cilesise. Infosoft Office ka paraqitur ne tender 12 certifikata cilesie, pra per secilin prodhues certifikaten respektive. OE i renditur i pari ka paraqitur vetem nje certifikate cilesie, gje qe do te thote: 1. Ose te gjitha tonerat i ka prodhuar i njejti prodhues, pra kemi te bejme me tonera kompatibel, nderkohe qe kerkesa kryesore ne tender ishte qe tonerat te jene origjinal dhe jo kompatibel, jo të rimbushur, jo remanufactured; 2. Ose ka paraqitur certifikaten e vetem njerit prej prodhuesve dhe i mungoj ne 11 certifikata te tjera, te 11 prodhuesve te tjere. Pra i mungojne 11 dokumenta qe duhej ti kishte paraqitur ne tender. Ne te dyja rastet. OE i*

*renditur i pari duhej te ishte skualifikuar: 1. ose per mosplotesim te specifikimeve teknike, pasi ne tender ishte vendosur kriter kualifikimi ofertimi me tonera origjinale dhe jo kompatibël, jo të rimbushur, jo remanufactured; 2. ose per mungesa ne dokumentacionin e paraqitur. Pas nje kerkimi qe beme ne internet na rezulton se certifikata me numer 00113Q213497R1M/4404 i perket nje kompanie prodhuese tonerash kompatibel dhe qartesisht kjo gje duket ne faqen zyrtare te kesaj kompanie. Lutemi beni edhe ju verifikimet tuaja per sa me siper. OE i jane kerkuar edhe mostrat, qe sipas Bashkise Elbasan, jane origjinale. Nga pergjigja e AK nuk e kuptojme nese mostrat e paraqitura nga OE jane produkte te kompanise per te cilen ka paraqitur ISO 9001? Apo dokumenti i paraqitur ne tender ISO 9001:2008 i perket nje prodhuesi tjetër dhe mostrat i perkasin prodhuesve te tjere, gje qe do te ishte nje tjetër parregullsi ne oferten e ketij OE? Ne keto kushte i kthehemi serisht kerkeses tone per te verifikuar edhe nje here argumentimin e paraqitur nga ky OE per oferte anomalisht te ulet: a ka sjelle ky operator fatura te mepareshme ose oferta zyrtare qe vertetojne aftesite e tij per te blere tonera origjinale me cmime kaq te uleta? A jane keto fatura te kompanive qe tregtojne tonera origjinale? Apo faturat tregojne blerjen e tonerave kompatibel? Mesa shohim, fakti qe ne respektoam dhe permbushem te gjitha specifikimet e vendosura nga AK, na penalizoi duke humbur tenderin ne menyre te padrejte. Specifikimi: Tonerat te jene original dhe jo kompatibël, jo të rimbushur, jo remanufactured, perben nje ndryshim thelbesor ne cilesine e tonerave qe pasqyrohet natyrisht edhe ne cmim.[...]”*

II.7.Në datën 22.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3119/1prot., datë 21.05.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes,

#### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ”Infosoft Office” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Artan Llozana” p.f., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “*Certifikata e kerkuara eshte certifikate qe i perket prodhuesit te tonerave. Sqarojme qe ne tender kerkoheshin 12 lloje (marka) tonerash, qe prodhohen nga 12 prodhues te ndryshem. Cdo lloj (marke) toneri ka prodhuesin e vet respektiv. Ne tender kerkoheshin tonera: Konica Minolta; Brother; Kyocera; Xerox; Canon; Ricoh; Toshiba; Lexmark; HP; Samsung; Oki; Sharp; Epson. Secili nga keta prodhues eshte kompani me vete (nuk ka asnje lidhje mes ketyre prodhuesve) dhe ka secili certifikaten e vet te cilesise. Infosoft Office ka paraqitur ne tender 12 certifikata cilesie, pra per secilin prodhues certifikaten respektive. OE i renditur i pari ka paraqitur vetem nje certifikate cilesie”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.3.5 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“5.Operatori ekonomik duhet te paraqes: Certifikate ISO 9001:2008 per menaxhimin e cilesise (te vlefshme). Certifikata e kerkuara eshte certifikate qe i perket prodhuesit te tonera”*

III.1.2.Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

*“[...]Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.*

*•Tonerat për printera dhe fotokopje duhet të jenë Origjinale prodhuar nga prodhuesit e pajisjeve perkatese (OEM,GENUINE), jo kompatibël, jo të rimbushur, jo remanufactured.*

*•Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit ”Genuine”.(Ato tonera/bojëra të cilat prodhuesi i pajis me pullën e sigurisë ”Genuine”).*

*•Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të mbështjellë me qese dhe të ambalazuara në kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.*

*•Modeli i printerit dhe kodi i bojës duhet të jenë të printuara në kuti dhe jo në etiketa që ngjiten. Numri i serisë së kutisë duhet të korrespondojë me numrin e serisë së cartridge brënda në kuti.*

*•Tonerat per printera dhe fotokopje duhet te plotesojne sasine e faqeve sipas datashet-in dhe katalogut perkates te pajisjeve(printera,fotokopje)*

*•Tonerat inkjet duhet te kete date skandence jo me pak se 1 vit nga data e lidhjes se kontrates.*

*•Operatori ekonomik duhet te ofroje garanci per mallin e ofruar,si dhe nderrimin nga difekte fabrikimi.*

III.1.3.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Artan Llozana” p.f., ka dorëzuar:

1. Certifikatë ISO 9001:2015, e prodhuesit “Hosokaëa Alpine Aktiengesellschaft” e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
2. Certifikatë ISO 9001:2008, e prodhuesit ”Prospect Image Products Limited of Zhuhai” e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

III.1.4.Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...].”*

III.1.5.Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”*

III.1.6. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një*

*ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.7.Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe në dokumentacionin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor, nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, kërkon të blejë tonera (bojra) printer dhe fotokopje origjinale të prodhuara nga kompanitë prodhuese të këtyre pajisjeve, të cilat janë “*Kyocera; Brother; Konica Minolta; Xerox; Canon; Ricoh; Toshiba; Lexmark; HP; Samsung; Oki; Sharp; Epson, Dell, Pantum,*” si dhe përcakton në mënyrë eksplicite se tonerat (bojrat) nuk duhet të jenë kompatibël, të rimbushur, apo remanufactured. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin certifikatat e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 të prodhuesve të tonerave (bojrave) që do të ofrohen. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në përmbushje të kriterit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Artan Llozana” p.f. ka paraqitur 2 (dy) certifikata të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 të prodhuesve “Hosokaëa Alpine Aktiengesellschaft” dhe “Prospect Image Products Limited of Zhuhai”. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik ofertues “Artan Llozana” p.f., nuk e ka përmbushur kriterin e sipërcituar të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi ky operator ekonomik duhet të kishte paraqitur certifikatat e menaxhimit të cilësisë të prodhuesve të tonerave (bojrave) origjinal, të cilët janë edhe prodhuesit e pajisjeve për të cilat nevojiten mallrat objekt prokurimi dhe jo të kompanive prodhuese të tjera. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “Artan Llozana” p.f. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Artan Llozana” p.f. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë pasi operatori ekonomik “Artan Llozana” p.f. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt “Blerje Kancelari dhe Bojra për vitin 2018 për Bashkinë, QKR, Agjensia e Pyjeve dhe SHMZSH”, me nr. REF-59330-03-28-2018, me fond limit 5,391,933 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Artan Llozana” p.f. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 886 protokoli Datë 10.05.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**